

1 E mërkurë, 10 janar 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.31

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi. Mirë se vini.

7 Znj. Sekretare, thërrisni lëndën ju lutem.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
9 çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër
10 Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Shoh që në anën time të djathtë përbërja e Prokurorisë
14 është e njëjta. Në anën e majtë, shoh një ndryshim të vogël.

15 Z. Avokat, keni fjalën.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Faleminderit. Është i njëjti
17 ekip, përveç znj. Cheng, që është sot këtu me neve. Pjetër
18 Shala është i pranishëm.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
20 konstatojmë edhe ne.

21 Z. Shala, mirëmëngjesi. E konfirmoni që më dëgjoni mirë?

22 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju ndëgjoj
23 shumë. Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 rregull.

1 Sot vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 4405, z. Safet
2 Gashi. Do të bëjmë tre seanca të rregullta, me pushimet e
3 zakonshme.

4 Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit, do të
5 japim një urdhër gojor lidhur me njoftimin shtesë të rregullës
6 102(3) të Prokurorisë, që është parashtrimi i protokolluar
7 F758, i datës 8 janar 2024.

8 Duke patur parasysh numrin e kufizuar të materialeve, do
9 të veprojmë si në vijim me qëllim që Mbrojtja t'i marrë këto
10 materiale në mënyrë sa më të shpejtë, nëse i kërkojnë.

11 Mbrojtja duhet të informojë ZPS-në cilat materiale nga
12 këto të renditura në njoftim dëshiron të ketë dhe, pra, përmes
13 nxjerrjes apo konsultimin të materialeve, duhet të japë një
14 njoftim sot, në datën 10 janar në orën 13.00.

15 ZPS-ja duhet të nxjerrë dhe të japë qasje në këto
16 materiale të caktuara të kërkuara nga Mbrojtja deri në pra,
17 sot, deri të enjten, 11 janar 2024, në orën 13.00.

18 Nëse Mbrojtja kërkon qasje dhe nxjerrje të materialeve
19 sipas rregullës 102(3) që kërkojnë, për të cilat duhen
20 redaktime, ZPS-ja duhet të bëjë kërkesë pranë Trupit Gjykues
21 të njëjtën ditë, pra, të enjten 11 janar 2024, në orën 13.00.

22 Në qoftë se ZPS-ja dëshiron të kundërshtojë
23 materialitetin e dëshmive të kërkuara nga Mbrojtja, duhet për
24 këtë të bëjë, të paraqesë këtë kundërshtim përpara Trupit
25 Gjykues deri të mërkurën, në datën 10 janar 2024.

1 Me këtë përfundon urdhri gojor i Trupit Gjykses.

2 Mund të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitar.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Që të shënohet në
4 procesverbal, ne kemi kërkuar tashmë të gjitha materialet që
5 dje. Nuk janë shumë në fakt. Besoj se janë nga ato që janë të
6 rëndësishme dhe relevante për ne. Tani, kërkesën ne e kemi
7 bërë, topi është në anën e ZPS-së, në qoftë se mund të them,
8 në qoftë se kanë ndonjë kundërshtim apo redaktime për të bërë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit për këtë informacion.

11 Znj. Prokurore.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ne kemi disa referenca që donim
13 t'i jepnim me qëllim të qartësimi dhe saktësimi për
14 Mbrojtjen, mund të japim tani apo më vonë?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
16 t'i jepni më vonë, sepse në qoftë se futet dëshmitari në sallë
17 dhe ne jemi duke folur nuk është momenti i përshtatshëm.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Në rregull.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

22 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
24 jeni sot?

25 DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull.

3 Z. Shala, e dëgjoni dëshmitarin?

4 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj mirë.
5 Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 rregull.

8 Z. Dëshmitar, ju kujtoj që jeni akoma nën betim për të
9 thënë të vërtetën. E kuptoni këtë?

10 DËSHMITARI: Po.

11 DËSHMITARI: SAFET GASHI [Vijon]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
13 ia jap fjalën znj. Prokurore për të vazhduar me marrjen në
14 pyetje nga ana e Prokurorisë së Specializuar.

15 Znj. Prokurore, deri tani keni përdorur një orë dhe 16
16 minuta për pyetjet tuaja. Është afër kohës që është përdorur
17 nga Mbrojtja. Ata kanë përdorur një orë e 22 minuta në tërësi.
18 Ne do t'ju lejojmë juve që të vazhdoni me pyetjet tuaja ndaj
19 dëshmitarit për aq kohë sa është e nevojshme dhe ne e
20 vlerësojmë të rëndësishme për gjetjen e së vërtetës.

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

22 Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo:

23 [Vazhdim]

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

25 PY. Mirëmëngjesi, z. Gashi.

1 PË. Mirëmëngjes.

2 PY. Dua të filloj me disa pyetje për afate kohore, pra, ose
3 data. Z. Gashi, dje na thatë se keni qenë në Kosovë deri në
4 shkurt ose mars momenti "kur ju kanë dëbuar në Shqipëri forcat
5 serbe". Kjo është në transkript 3899, rreshtat 5 deri në 6.

6 Gjithashtu deklaruat se jeni largu nga Kosova rreth
7 për afërsisht tre ditë pasi janë largu familja juaj drejt
8 Shqipërisë. Në të njëjtën faqe të transkriptit të djeshëm,
9 pra, gjendet edhe ky informacion, 3899, rreshtat 18 dhe 19.

10 Ju kujtohet që e keni thënë këtë dje?

11 PË. Po.

12 PY. A ju kujtohet ndonjë ngjarje e veçantë që ka ndodhë
13 përpara se familja juaj dhe ju të largoheni nga Kosova?

14 PË. Jo.

15 PY. Ky dëbim nga serbët i familjes tuaj, a ka ndodhë përpara
16 apo mbas bombardimeve të NATO-s?

17 PË. Nuk më kujtohet kjo.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund t'ia
19 freskojë dëshmitarit kujtesën lidhur me këtë pyetje me një
20 pjesë të deklaratës së tij?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Vazhdoni.

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] A mund të shfaqet në ekran
24 dokumenti 063317-TR-ET Pjesa 1 RED2, faqja 14, rreshtat 18,
25 19.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

2 Sekretare, shfaqni dokumentin në ekran.

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

4 PY. Z. Dëshmitar, këtu përballë jush keni versionin në
5 anglisht, do ta lexoj në anglisht dhe do t'ju përkthehet në
6 shqip pra. Rreshti 17, ju thoni:

7 "Le ta bëjë të qartë. Kur kanë fillu bombardimet, familja
8 ime ka shku në Shqipëri, ka ik për Shqipëri dhe unë kam shku
9 me luftu në luftë. Kur NATO ka fillu me bombardu në atë vend
10 unë jam bashkangjit luftës".

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Në qoftë se mund të kemi dhe
12 faqen 12, rreshtat 17, 21, për nevoja të qartësimit të
13 mëtejshëm dhe për kontekst. A mund të shohim pak në pjesën e
14 sipërme të faqes? Në fillim ndoshta?

15 Kërkoj ndjesë, në fakt kjo është Pjesa 1. Neve na duhet
16 Pjesa 2, pjesa e dytë e deklaratës, me të njëjtin numër ERN.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
18 mund të nxirrni dokumentin e kërkuar në ekran, znj. Sekretare?

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faqe 12. Në rregull. Rreshti 17

20 PY. Z. Dëshmitar, edhe këtu po lexoj nga deklarata,
21 intervista e ZPS-së:

22 "Gjatë dy apo tre ditëve të para kur ka fillu bombardimi
23 i NATO-s familja ime qëndroi në Kosovë. Edhe unë kam qëndru
24 aty. Nuk i isha bashkangjit luftës hala. Kam shku në qytet për
25 me ble cigare. Kur jam kthi në shtëpi, familja ime ishin largu

1 për drejt Shqipërisë. Edhe unë jam bashkëngjijt UÇK-së po atë
2 ditë, të njëjtën ditë”.

3 Z. Gashi, a jua freskon kujtesën kjo lidhur me faktin --
4 PË. Po.

5 PY. -- që ka qenë një ngjarje e veçantë --

6 PË. Po. Unë e thashë edhe --

7 PY. -- ku të janë largu familja?

8 PË. Po. Unë e thashë edhe më herët, nuk më kujtohet, po
9 ekzakt është kjo kështu. Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

11 Dëshmitar, ju kujtoj se jeni këtu për të thënë të vërtetën dhe
12 për të mos fshehur asgjë --

13 DËSHMITARI: Asgjë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] --

15 për atë që ju dini. Thjesht na vë në pikëpyetje pak fakti që
16 ishte kaq e vështirë t’ju kujtohet diçka kaq e rëndësishme.

17 Vazhdoni, znj. Prokurore.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

19 PY. Z. Gashi, ju konfirmuat që jeni larguar nga Kosova pas
20 bombardimit të NATO-s, që ne e dimë ka fillu në 24 mars 1999.

21 A është e saktë të themi që keni shku në Shqipëri në fund apo
22 rreth fundit të marsit 1999?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit.

25 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani mund

1 ta heqim dokumentin nga ekrani. Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni, znj. Sekretare.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

5 PY. Z. Gashi, dua të qartësoj diçka tjetër me juve. Sa herë
6 ke shku në Kukës gjatë periudhës së luftës?

7 PË. Kam thënë edhe dje këtë pyetje, veç një herë jam kanë.

8 Data nuk më kujtohet. Veç kam shku e kam dhe ba regjistrimin

9 tim kam marrë uniformën dhe kam shku në Kolsh apo në Kalimash.

10 PY. Z. Gashi, dje, gjatë marrjes në pyetje nga Avokati

11 Mbrojtës, ju thatë që keni shku në Kukës në mars 1999 bashkë

12 me pesë apo gjashtë shokë për me marrë armë. Dhe se gjatë --

13 që në këtë rastin jeni ndal shkurt, shumë pak në Kukës për me

14 pushu dhe mandej keni vazhdu në Kalimash. Kjo është thënë dje

15 dhe është shënuar në transkript në faqen 3199, rreshtat 20,

16 31. A ju kujtohet që e thatë këtë?

17 PË. Po, ashtu është.

18 PY. Pastaj shpjeguat që në Kukës ju kanë dhënë uniformën dhe

19 me këtë rast i keni dhëna të dhënat personale Ruzhdi Saramatit

20 dhe e keni bërë betimin në një ndërtesë një katëshe. Kjo është

21 në transkriptin e djeshëm, faqe 3956, rreshti 23 dhe 3957,

22 rreshti 24.

23 Ju kujtohet që e keni thënë këtë?

24 PË. Po, e vërtetë është.

25 PY. Faleminderit. Tani kjo na çon, na krijon dy raste të

1 ndara të veçanta që keni qenë në Kukës, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Megjithatë dje thatë edhe diçka tjetër duke u përgjigj
4 një pyetje të bërë nga Mbrojtja, lidhur me momentin kur jeni
5 kyç në UÇK. Dhe dje thatë - kjo është në transkript në faqen
6 3906, rreshti 16, 21 - se keni shku nga Prizreni drejt e në
7 Gorozhup. Thatë nga Prizreni keni shku drejt e në Gorozhup.

8 Kjo është shumë ndryshe prej asaj që na thatë neve në
9 përgjigjen e pyetjeve tona, apo jo?

10 PË. Jo, e keni marrë vesh pyetjen gabim. Unë kam shku në
11 Kukës të parën herë, pi Kukësit jam shku në Kalimash, prej
12 Kalimashit jemi largu prej shtatë-tetë ditëve për afërsisht apo
13 dhjetë ditë në Gorozhup. Këtë e kam thënë unë.

14 PY. Së pari a mund të sqaroni atëherë pse iu përgjigjët
15 Avokatit Gilissen, dje i thatë që keni shku nga Prizreni në
16 Gorozhup drejtpërdrejt. Si e shpjegoni që thatë këtë?

17 PË. Jo. Unë e kam thënë në Kukës. Në Kukës e kam bërë
18 regjistrimin, kam marrë uniformën edhe kem shku në Kolsh apo
19 në Kalimash.

20 PY. Në qoftë se është e nevojshme mund të lexoj pjesën në
21 tërësi për të pa sesi jeni përgjigjur.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
23 ta bëni këtë gjë.

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faqja 3906, rreshti 16.

25 PY. Avokati thotë:

1 "Faleminderit. A e kuptoj që keni fillu nga Kosova dhe
2 keni shku në Gorozhup drejt menjëherë apo keni bë ndonjë
3 udhëtim diku tjetër?

4 "PË. Në Gorozhup

5 "PY. Nga Prizreni drejt në Gorozhup?

6 "PË. Po".

7 Pra, kjo nuk është e njëjta gjë sikur ajo që thatë sot,
8 z. Dëshmitar, apo jo?

9 PË. Ndoshta s'ia kam kuptu pyetjen z. Avokat mirë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Pyetja dukej shumë e qartë.

12 Vazhdoni, znj. Prokurore.

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

14 PY. Z. Gashi, dje fillimisht i thatë z. Gilissen, i treguat
15 të njëjtën histori që më treguat mua pasdite, që keni shku në
16 Kukës, pastaj në Gorozhup. Por mandaj keni ndryshu historinë
17 kur z. Gilissen ju kujtoj deklaratën tuaj që i kenë dhënë më
18 herët ZPS-së. Apo nuk është kështu?

19 PË. Ashtu është.

20 PY. A është ajo që po thoni është që befasisht e keni ndryshu
21 versionin e historisë tuaj dje? A po pranoni këtë?

22 PË. Jo, jo. Ama unë nuk e kam kuptu pyetjen, thash edhe para
23 Trupit Gjykses. Unë kam shku të parën ditë kur kam shku, të
24 marsit ato ditë, nuk më kujtohet data saktë, unë jam kanë në
25 Kukës. Në Kukës e kam marrë uniformën dhe kam shku për në

1 Kalimash apo Kolsh. Nuk ia kam kuptu z. Avokatit pyetjen mirë
2 PY. Po pyetja ishte shumë e qartë. Avokati ju ka pyet a keni
3 shku nga Kosova drejt e në Gorozhup edhe ju keni thënë po.
4 Kështu që nuk e shoh se çka ka pasë të paqartë aty?

5 PË. Nuk e kam pyetjen ndoshta mirë, po e them për të tretën
6 herë këtë. Unë jam shku në Kukës, kam marrë uniformën edhe
7 jemi largu larg Kukësit diku janë 30-40 kilometra. Nuk më
8 kujtohet sa ka ajo afërsi larg Kukësit kjo.

9 PY. Z. Gashi, në deklaratën tuaj që i keni dhënë ZPS-së, ju
10 keni thënë që gjatë dislokimit me UÇK-në s'keni qenë kurrë në
11 Kukës. S'keni qenë kurrë në Shqipëri. A ju kujtohet që e keni
12 thënë këtë në 2019?

13 PË. E kam thënë po. Unë e kam thënë, e pranoj, po kam deshtë
14 me thënë në Kukës nuk jam kanë, jo në Shqipëri. E pranoj.
15 Mirrmi vesh në Kukës një orë apo dy, e kam cekë edhe dje, kam
16 nejt në Kukës, më tepër asnjë.

17 PY. Në fakt nuk keni thënë kështu z. Gashi. Dhe ndoshta do të
18 ishte mirë në qoftë se Gjykata më lejon ju të lexoni vetë
19 deklaratën tuaj që i keni dhënë ZPS-së në 2019.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Vazhdoni, ju lutem. Po përpara se të vazhdoni, do t'ia jap
22 fjalën Avokatit Mbrojtës.

23 Z. Avokat, keni fjalën ju.

24 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Duke qenë se s'kemi
25 transkriptin në gjuhën shqipe, ndoshta mund të shfaqim

1 regjistrimin me zë, që dëshmitari të dëgjojë në gjuhën e tij,
2 përndryshe është e vështirë. Besoj që teknikisht është e
3 vështirë për t'u bë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
5 besoj që është e nevojshme ajo. Nuk kam problem me përkthimin
6 që bëhet këtu.

7 Z. AOUINI: [Përkthim] Ne nuk po këmbëngulim, sepse e di
8 që është teknikisht e vështirë. Por që dëshmitari është mirë
9 që të kishte versionin origjinal në gjuhën e tij përpara tij.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
11 vazhdojmë në këtë mënyrë.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
13 mund të shfaqet në ekran dokumenti 063317-TR-ET Pjesa 2 RED2,
14 në faqen 10.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
16 Sekretare, vazhdoni.

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

18 PY. Z. Gashi, në 2019, kjo është deklarata jua që i keni
19 dhënë ZPS-së dhe fillon në rreshtin 11:

20 "PY. Ne mesa dimë disa prej pjesëtarëve të Brigadës 128
21 janë grumbulluar afër kufirit për në Shqipëri, përpara që të
22 fillonin operacionin.

23 "PË. Nuk e di këtë. Mund t'i thoni kësaj zonjës se ka të
24 drejtë, ata duhet të kenë ardhë prej Shqipërisë. Por dy këmbët
25 e mia nuk kanë hy kurrë në territorin e Shqipërisë. Kurrë".

1 PË. Kam deshtë me thënë Kukës, znj. Prokurore. Jam habit që
2 kam thënë ashtu. E pranoj këtë.

3 PY. Z. Gashi, ju keni përmend këtu tokën e Shqipërisë. Nuk po
4 flitet për shtabin e Kukësit apo diçka të tillë. Ju keni
5 përmend dhe fol këtu territorin, tokën e Shqipërisë?

6 PË. Po, e pranoj. E pranoj.

7 PY. Z. Gashi, sot duke u përgjigjur pyetjes time ju
8 konfirmuat që keni shku në Shqipëri, në Kukës, dy herë gjatë
9 luftës, a është kështu?

10 PË. Një herë. Thashë edhe më herët, një herë.

11 PY. Në fakt, unë ju dhashë dy shembuj të ndryshëm: Hera kur
12 keni shku për t'u regjistru, keni bë betimin me z. Saramati
13 dhe pastaj ju përmendët një rast tjetër, kur keni shku atje më
14 5 a 6 shokë për me marrë armë.

15 PË. Po ajo ditë u kanë. Dita e marsit kur jam shku pi Kosove.
16 Atë ditë u kanë.

17 PY. Nga mënyra sesi i ke përshkru këto dy momente, ato duken
18 si me qenë dy raste të ndryshme dhe mënyra sesi fole për të
19 duken sikur janë dy ditë të ndryshme. Njëni moment kur keni bë
20 betimin dhe ke përmendet dje dhe se dje nuk i ke përmend armët
21 fare për momentin e betimit dhe pastaj kur keni kalu përmes
22 Kukësit dhe keni marrë armët, apo jo?

23 PË. Znj. Prokurore, atë ditë u kanë krejt kjo ngjarje sikur e
24 kam cekë. Atë ditë kur kam shku pi Kosove jam shku në Kukës,
25 kem marrë uniformën, kem marrë armatim, po armatimin na kanë e

1 dhënë pa fishek, se s'kemi ditë, dikush ka ditë me përdorë,

2 dikush jo. Atë ditë është fjala këto çka ndodhë.

3 PY. Atëherë z. Gashi, a nuk e konfirmove pak më herët kur ju

4 pyetën nëse bëhej fjalë për dy ngjarje të ndryshme, ju e

5 konfirmuat thatë "Po" që janë dy të ndryshme --

6 PË. Jo, nuk e kam thënë.

7 PY. -- kjo është në faqen 8 të transkriptit të sotëm.

8 Në fakt, e keni thënë këtë gjë, në rreshtin 10, 12. Po e

9 lexoj transkriptin, rreshti 10:

10 "Faleminderit. Pra, bëhet fjalë për dy raste të ndryshme

11 që keni qenë në Kukës gjatë luftës?

12 Përgjigja jote:

13 "Po".

14 Apo ndërroni edhe një herë versionin e ngjarjeve këtu?

15 PË. Znj. Prokurore, unë me ty s'po kuptohna aq mirë. Unë po

16 them të vërtetën. Një herë jam kanëë në Kukës kur jam hi pi

17 Kosove. atë ditë ka ndodhë kjo krejt.

18 PY. Faleminderit, z. Gashi. Kam një pyetje tjetër.

19 PË. Po, urdhno.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

21 Prokurore.

22 Z. Dëshmitar.

23 DËSHMITARI: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

25 lutem përpiquni që të përgjigjuni në mënyrë sa më të saktë që

1 keni mundësi me qëllim që të shmangen keqkuptime të ndryshme.

2 DËSHMITARI: Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e
4 kuptoni këtë?

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Pesha, vlerësimi i dëshmisë tënde bëhet më vonë. Por ju
8 inkurajoj që të thoni të vërtetën, sepse këtu jemi për të gjet
9 të vërtetën, për të gjet faktet. Nëse nuk jeni i saktë në
10 përgjigjet tuaja, kjo punë për ne bëhet e vështirë. Ju
11 ballafaquat me disa mospërputhje të mundshme lidhur mes asaj
12 që ke thënë në deklaratat e dhëna ZPS-së dhe asaj që po
13 deklaron në Gjykatë dhe ne do ta vlerësojmë këtë më vonë, por
14 kjo ngre ca pikëpyetje të rënda, serioze lidhur me faktin se
15 ku është e vërteta këtu.

16 Thjesht desha t'ju kujtoj këtë. Nuk keni nevojë që të
17 bëni komente për këtë. Nuk ua jap fjalën, po ia jap fjalën
18 përsëri znj. Prokurore.

19 Znj. Prokurore, keni fjalën.

20 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
22 Prokurore, dokumenti i mëparshëm është ende në ekran. Doni ta
23 përdorni?

24 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Znj. Sekretare ju lutem mund ta heqim nga ekrani.

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

4 PY. Z. Gashi, kam edhe një gjë të fundit lidhur me këtë.

5 Thatë se ishte i njëjti episod. Por, mënyra sesi e keni
6 përshkruar këtë episod dhe është mjaft ndryshe, mjaft e
7 ndryshme, në kuptimin që kur cekni se keni shkuar në Kukës për
8 të marrë armët, keni cekur se keni shkuar aty me karvan për të
9 marrë armë. Pra, duhet të të keni qenë kyçur në UÇK në atë
10 moment, pra, tashmë. Pra, edhe njëherë, mos po flasim këtu për
11 dy raste të ndryshme në të cilat keni shkuar Kukës?

12 PË. Jo, znj. Prokurore. Ai rast është. Unë dhe dhe e kam
13 cekë. Me kombajse na kanë çu, na kanë dhënë uniformën,
14 armatimin dhe na kanë çu në Kalimash. Ajo pyetje është, znj.
15 Prokurore.

16 PY. Z. Gashi, dua t'ju bëj një pyetje tjetër atëherë. Ne e
17 lexuam këtë më herët. Përse në vitin 2019 ju e keni mohuar
18 faktin që keni qenë në Shqipëri, përpara ZPS-së? Cilat arsye
19 kishit për të mohuar qoftë edhe që keni kaluar në Kukës për të
20 marrë uniformën? Na e shpjegoni dot këtë?

21 PË. Po. Thashë edhe më herët, jam habit. Kam deshtë me thënë
22 në Kukës e kam thënë në Shqipëri. Se në Shqipëri jam kanë,
23 domethënë, në mars, vitin 1999. Ezaktë është kjo.

24 PY. Ju është bërë pyetje për Shqipërinë, për Kukësin, për
25 uzinën metalike të Kukësit në disa raste, në disa momente të

1 intervistës dhe ju keni përsëritur atëherë se nuk keni qenë
2 kurrë aty.

3 PË. E vërtetë është.

4 PY. Çfarë arsye kishit, pra, për të thënë që nuk keni qenë
5 kurrë në Shqipëri gjatë luftës? Çfarë është e vërtetë, z.
6 Dëshmitar? Sepse mbase nuk ju kuptoj tani në këtë moment.

7 PË. E vërtetë është se pyetjen në 2019 mu kanë bërë mu flitet
8 për Kukës për do fabrika, për do sene, kurse unë nuk jam kanë
9 aty. Po unë jam kanë në Kalimash apo Kolsh.

10 PY. Po jo, pyetja ime ishte paksa ndryshe, z. Dëshmitar.

11 Pyetja është se përse keni thënë se s'keni qenë kurrë në
12 Shqipëri dhe në një vend të caktuar të Kukësit?

13 PË. Unë tri herë jam ka e përsëris më duket këtë, znj.

14 Prokurore. Jam habit. Kam deshtë me thënë në Kukës nuk kam
15 qenë, domethënë, për me flejtë sikur që kam qenë tjetër ku.

16 Unë jam kanë në Kalimash apo Kolsh si i thojnë, nuk e di atë
17 vend.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

19 Prokurore, dua -- pra edhe njëherë z. Dëshmitar, siç ju thashë
20 më përpara --

21 DËSHMITARI: Po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] --

23 unë nuk do ta vlerësoj tani dëshminë tuaj këtë që po thoni në
24 Gjykatë. Ne vetëm sa po ju dëgjojmë, sa po ju mbajmë vesh. Por
25 ju keni thënë disa herë, siç e ceku znj. Prokurore:

1 "Nuk kam shkelë me këmbë, me këto dy këmbë në tokë
2 shqiptare. Nuk kam qenë në Shqipëri, nuk kam shku, pra, në
3 Shqipëri".

4 Dhe kur keni folur për familjen tuaj:

5 "A i keni vizituar ndonjëherë në Kukës?"

6 Dhe ju keni thënë:

7 "Jo. Si mund të hyjsha unë aty".

8 Dhe nuk po them më shumë. Pra, është e vështirë që të
9 kuptoj dhe unë këtu jam për t'ju kuptuar juve, s'kam asnjë
10 punë tjetër, vetëm këtë kam si punë. E kam të vështirë të
11 kuptoj shpjegimin tuaj që jeni bafasu sepse është shumë e
12 vështirë, pra, për të kuptuar nga kjo, pra, se ka pasur befasi
13 kur ju thoni të njëjtën gjë por në momente të ndryshme.

14 E kuptoni qëndrimin tonë? Këtu nuk jemi këtu që t'ju
15 kapim juve në ngecje diku. Dua vetëm të kuptojë atë që po na
16 tregoni. Prandaj tani keni fjalën të na shpjegoni nga rrjedhë
17 kjo befasi, kjo ngatërresë? Ju lutem na ndihmoni të kuptojmë.

18 DËSHMITARI: Zonja -- po. Znj. Gjyqtare, unë e thashë edhe
19 njëherë, jam habit. Kam deshtë me thënë në Kukës nuk kam
20 qëndru, e kam thënë në Shqipëri. Jam ka e ceku këtë e treta
21 herë, znj. Gjyqtare.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
23 po e thoni për herën e tretë, por ende nuk po e shpjegoni
24 përse në disa momente të ndryshme kohore duket sikur habitja
25 është po ajo e vazhdueshmja dhe unë këtë po përpiqem të

1 kuptojë.

2 Megjithatë pyetja ime ishte e qartë. Ju përgjigjen tuaj e
3 dhatë. Kështu që unë tani po ia jap fjalën znj. Prokurore.

4 Znj. Prokurore, keni fjalën.

5 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
6 Gjykatës.

7 PY. Z. Gashi, Na keni thënë sot se keni marrë armët dhe
8 uniformën në Kukës. Kështu na thatë, apo jo?

9 PË. Po, e vërtetë.

10 PY. Mirëpo, nuk i keni thënë kështu ZPS-së në vitin 2019,
11 sepse aso kohe thatë se uniformën dhe armët i keni marrë në
12 Gorozhup, a nuk keni thënë kështu atëherë?

13 PË. Nuk më kujtohet kjo.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse mund
15 të përdor edhe një herë deklaratën e mëparshme për t'i
16 rifreskuar kujtesën dëshmitarit?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
18 Mundet.

19 Znj. Sekretare, me të marrë numrin e referencës mund ta
20 vendosni.

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Atëherë numri i ERN është
22 063317-TR-ET Pjesa 1 RED2, faqja 11, rreshtat 19 deri në 21.

23 PY. Z. Gashi, aso kohe ju bë kjo pyetje:

24 "Thatë se morët uniforma dhe armë. A është pikërisht në
25 atë moment që ua kanë dhënë uniformat dhe armët?"

1 Dhe ju jeni përgjigjur:

2 "Po, po, në Gorozhup".

3 PË. Znj. Prokurore, unë nuk e di çfarë mendimi ose me çfarë
4 mendimi mundet me shku një person me hi në luftë pa armatim.

5 Unë po e them të vërtetën dhe veç të vërtetën, unë armatimin e
6 kam marrë në Kukës.

7 PY. Z. Gashi, atëherë mund të na thoni sesi mund të shkoj
8 dikush në luftë pa armë, se ju keni qenë në luftë. Pra, si
9 është e mundshme atëherë? Si mund ta shpjegoni?

10 PË. Po, znj. Prokurore, mund ta shpjegoj. Se ka që ka mbaru
11 lufta në Kosovë mbi 25 vjet. Unë edhe bën vaki kam harru diçka
12 sun i ceki detajisht me datë të saktë apo ku apo tek, se
13 mundet me harru edhe njëri.

14 PY. Z. Gashi, marrja e armëve dhe uniformave nuk është një
15 detaj shumë i vogël për një ushtar në luftë --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
17 ta heqim këtë dokument nga ekrani?

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
20 lutem, znj. Sekretare.

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

22 PY. Z. Gashi, pra, a pajtoheni me mua nëse them që ka një
23 diferencë të madhe, pra, dallim të madh midis asaj që i keni
24 thënë ZPS-së në 2029 dhe asaj që po thoni sot?

25 PË. Po, mundet me pasë dallim. E pranoj. Aman dallimi mundet

1 me harru njeri, sikur unë që kam harru. Jam kanë në 2019 në
2 shtator, unë kam mendu se jam kanë 2019, domethënë, në prill.
3 E patë edhe vetë gabimin që e kam bë se e kam harru. Harron
4 njeri, 5 vjet kanë kalue. Se le e më po më folni për do fjalë
5 që kanë ndodhë para 25 vitesh, znj. Prokurore. Kam harru.
6 PY. Faleminderit, z. Gashi. Do të kaloj në një temë tjetër.
7 Dje Avokati i Mbrojtjes ju pyeti për stërvitjen me UÇK-në dhe
8 dy herë thatë se stërvitje keni bërë vetëm në Gorozhup.

9 Kjo është në faqen 3909, rreshti 1 deri në 3, faqja 3909,
10 rreshtat 24 deri në faqe 3910, rreshti 1.

11 Pastaj ju thatë se jeni stërvitur në Kalimash ku jeni
12 stërvit me përdorë armët e gjata edhe granata, pra, bomba
13 dore. Ju e thatë këtë në faqen 3960, ndoshta 8 deri në 10.

14 A ju kujtohet që e keni thënë këtë dje?

15 PË. Shumë mirë më kujtohet. Shumë mirë më kujtohet. Kemi bë
16 ushtrime edhe në Kalimash po edhe në Gorozhup. Në dy pjesë
17 kemi bë nga pak, domethënë, ushtrime. E vërtetë është, znj.
18 Prokurore.

19 PY. Mirëpo, z. Dëshmitar, ju keni thënë diçka mjaft të
20 ndryshme në deklaratën tuaj para ZPS-së në vitin 2019. Aso
21 kohe ju thatë që nuk keni bërë stërvitje fare. Se thatë që
22 keni qenë gjahtar e dinit si t'i përdornit armët, nuk kishit
23 kohë të mjaftueshme me bë stërvitje se ishte kohë lufte. A ju
24 kujtohet që keni thënë kështu?

25 PË. Ashtu është.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

2 mund të na e thoni referencën, ju lutem?

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Patjetër. Është deklarata e

4 mëparshme 063317 Pjesa 1 RED2, faqja 11.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua

6 që të paraqitet në ekran, të shfaqet në ekran.

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, patjetër. Rreshti 22 i faqes

8 11.

9 Duhet ta lexoj?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

11 sepse mund ta ndihmojë dhe dëshmitarin.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

13 PY. Pra, z. Gashi, pyetja që ju bë në këtë rast ishte kjo:

14 "A bëtë ndonjë stërvitje?"

15 Dhe ju u përgjigjët:

16 "Njerëzit që dinin si të përdornin një armë nuk bënë

17 ndonjë stërvitje. Unë vetë s'kisha nevojë për stërvitje sepse

18 isha gjahtar para lufte".

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe ju lutem të kalojmë në faqen

20 12, faqen pasuese.

21 PY. Dhe aty u është bërë pyetje:

22 "Po ndonjë stërvitje si ushtar, se nuk është njësoj të

23 jesh ushtar me të jesh gjahtar?"

24 Ju u përgjigjët:

25 "Po, po, por nuk jam stërvit. Nuk na kanë stërvit. Nuk më

1 kanë stërvit".

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe nëse mund të kalojmë më
3 poshtë në të njëjtën faqe, rreshti 19.

4 PY. Këtu ju është bërë një pyetje tjetër:

5 "Po për sa i takon formacioneve ushtarake, si të
6 komunikoni midis njësive të ndryshme? Sepse ushtrive të
7 rregullta u bëhen lloj-lloj mësimesh për lloj-lloj gjërash si
8 të funksionojnë në ushtri. A ju mësuan ndonjë prej këtyre
9 gjërave?"

10 Ju thatë:

11 "Jo, se ishte kohë lufte nuk kishim shumë mundësi me u
12 stërvit".

13 Pra, Z. Gashi, si ka mundësi që në vitin 2019 ju thatë që
14 nuk keni bërë fare stërvitje, ndërsa ju sot thoni se jeni
15 stërvit në dy vende edhe në Shqipëri edhe në Kosovë? Përse?

16 PË. Po, po, është e vërtetë. S'jam stërvit. E pranoj. Aman jo
17 shumë, kush ka ditë me përdorë armët, unë e kam cekë këtë edhe
18 dje edhe dje e kam cekë, kanë mujt edhe me luftu pa pasë --
19 kanë pasë punë përvoja të ushtrisë. Apo si i themi edhe dje e
20 kam përmend këtë.

21 PY. Po, po, por nuk ju përgjigjët pyetjes time në fakt.

22 Pyetja ime ishte kjo përse nuk keni thënë në vitin 2019 që
23 jeni stërvit? Pra, pse ia keni mohu këtë ZPS-së? Atëherë, dy
24 herë keni thënë atë. Nuk jeni --

25 PË. E vërtetë është. Unë kam harru me tregu.

1 PY. Po pse thatë që nuk jeni stërvit? Ka ndonjë shpjegim për
2 këtë?

